

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

12 tetor 2009
Prishtinë
Pkl.-Kzz - 108/08

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë prej Gjyqtarit ndërkombëtar Emilio Gatti si Kryetar i kolegjit, Gjyqtarët ndërkombëtarë Norbert Koster dhe Guy Van Craen dhe Gjyqtarët Kosovarë Miftar Jasiqi dhe Feizullah Hasani si anëtarë të kolegjit,

në lëndën penale kundër:

Skender Halilaj, emri i babit **Daut**, emir i nënës Alfije, i lindur më 29 dhjetor 1961 në fshatin Tërdevë, Shqiptar i Kosovës, me vendbanim në fshatin Tërdevë në udhëkryqin a Abrijes; Kolonel Shef i Logjistikës, TMK; i martuar dhe ka tre fëmijë; ka mbaruar shkollën e mesme komerciale dhe di shkrim dhe lexim; me gjendje të mesme ekonomike; në burg prej 6 korrikut 2002 deri më 26 qershor 2008.

Kimete Krasniqi, emri i babait Fetah, emri i nënës Aleme Malaj (mbiemri i vajzërisë Gashi), e lindur më 24 prill 1980 në fshatin Negrovc; me vendbanim në 48/9, rruga Remzi Ademi në Prizren; vendbanimi në kohën e gjykimit i panjohur; e pamartuar; di shkrim dhe lexim; të ardhura mesatare; në burg prej 5 prillit deri më 30 tetor 2002; e gjykuar në mungesë.

Duke vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur 1) më 18 shtator 2008 nga avokati mbrojtës në emër të Kimete Krasniqit dhe 2) më 24 tetor 2008 të paraqitur nga avokati mbrojtës në emër të Skender Halilajt kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, AP-KZ 393/02006, të datës 20 maj 2008, i cili pjesërisht është ndryshuar nga Aktgjykimi i shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut në Gjilan në lëndën P.Nr. 162/2003, të datës 7 prill 2005, ka dënuar 1) të dy të pandehurit për kryerjen e veprës penale të vrasjes së qëllimshme në tentativë në kundërshtim të nenit 30, paragrafit 1 të LPK-së, lidhur me nenet 19 dhe 22 të Ligjit penal të RSFJ-së, i zbatueshëm me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24 (i dënueshëm edhe me nenin 146 të KPPK-së, lidhur me nenet 20 dhe 23 të KPPK-së) dhe 2) Kimete Krasniqin për kryerjen e veprës penale të posedimit të paligjshëm të armës në kundërshtim me nenin 199, paragrafin 1 të LPK-së dhe nenit 8.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/7 (i dëndeshim edhe me nenin 328, paragrafin 2 të KPPK-së).

Pas leximit të mendimit dhe propozimit të Prokurorit të ZPSK-së Znj. Deborah Wilkinson të paraqitur më 3 dhjetor 2008 dhe
Pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 12 tetor 2009.

Duke vepruar sipas neneve 410 dhe nga 451 deri në 460 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së), lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga Avokatja mbrojtëse Vahide Braha në dobi të Skender Halilajt, më 24 tetor 2008 REFUZOHET si e pabazë.

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga Avokati mbrojtës Destan Rukiqi në dobi të Kimete Krasniqit, e paraqitur më 18 shtator 2008 PRANOHET pjesërisht dhe lënda kthehet për rigjykim në Gjykatën e Qarkut të Gjilanit përkitazi me akuzën e Vrasjes së qëllimshme në tentativë, në kundërshtim me nenin 30, paragrafin 1 të LPK-së, lidhur me nenet 19 dhe 22 të Ligjit penal të RSFJ-së, për të cilën aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Gjilanit në lëndën P. Nr. 162/2003 të datës 7 prill 2005 dhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës AP - KZ 393/2006 i datës 20 maj 2008 ANULOHEN.

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga avokati mbrojtës Destan Rukiqi në dobi të Kimete Krasniqit, e paraqitur më 18 shtator 2008 PRANOHET pjesërisht dhe lënda kthehet për rigjykim në Gjykatën e Qarkut të Gjilanit në lëndën P. Nr. 162/2003 të datës 7 prill 2005 dhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës AP - KZ 393/2006 i datës 20 maj 2008 NDRYSHOHEN:

- sa i përket periudhës së kohës së akuzës që ka të bëjë me posedim të paligjshëm të armës, e cila zvogëlohet në periudhën prej 4 qershor 2001 deri më 6 prill 2002 dhe sa i përket cilësimit juridik të këtij fakti, i cili është vetëm shkelje e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/7, Neni 8.2;

- sa i përket llogaritjes së kohës së kaluar në paraburgim nga data 5 prill 2002 deri më 3 nëntor 2002.

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga avokati mbrojtës Destan Rukiqi në dobi të Kimete Krasniqit, e paraqitur më 18 shtator 2008 REFUZOHET si e pabazë në pjesën tjetër.

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës AP - KZ 393/2006 i datës 20 maj 2008 VËRTETOHET NË PJESËT E TJERA.

Shpenzimet e këtyre procedurave gjyqësore të ankimit do të barten nga të dy të pandehurit Skender Halilaj dhe Kimete Krasniqi, kjo e fundit do t'i bartë vetëm shpenzimet që lidhen me akuzën e posedimit të paligjshëm të armës.

Në përputhje me nenin 50 të KP të RSFJ-së, koha e kaluar në paraburgim nga secili i pandehur do të llogaritet në vuajtjen e dënimit.

ARSYETIMI

Historia e procedurës

1. Në pranverën vitit 1998 Hamëz Hajra, Polic i punësuar nga qeveria serbe, ishte synim i vrasjes në tentativë të kryer në udhëkryqin e rrugës Tërstenik 2 dhe Gllogoc-Skenderaj, ku ai kishte bërë marrëveshje për tu takuar me Kimete Krasniqin.

Kur Hamëz Hajra iu afrua Kimete Krasniqit ai u sulmua nga disa njerëz të veshur në uniforma të UÇK-së që dolën nga shkurret dhe qëlluan në veturën e tij.

Hajra arriti të vazhdojë të voziste drejt Gllogocit dhe i iku pusisë.

2. Në mbrëmjen e datës 20 gusht 2001 Hamëz Hajra, gruaja e tij Miradija, i biri i tij Xhevdeti dhe vajzat e tij Mimoza, Adelina dhe Pranvera shkuan në dasmë në shtëpinë e Sefedin dhe Rabishe Kiqinës për të festuar martesën e djemve të tyre Bashkim dhe Enver Kiqinës.

Dasma u bë në fshatin Baicë, Rabishe Kiqina ishte motra e Hamëz Hajrës.

Familja e Hajrës mbërriti në dasmë rreth orës 6 pasdite dhe u larguan rreth orës 11 të mbrëmjes, duke udhëtuar me një veturë të kuqe përgjatë rrugës që njihet me emrin rruga e urës së mëhallës së Lanit në mes fshatrave Baicë dhe Tërstenik.

Kur u afruan te ura e drurit vetura u qëllua me të shtëna dhe vetëm Pranvera Hajra i shpëtoi pusisë.

3. Kundër **Kimete Krasniqit**, prokurori publik paraqiti një aktakuzë më 3 korrik 2002 (nr. 305/2002) për vrasje në tentativë të Hamëz Hajrës të kryer në prill/maj 1998 dhe posedim të paligjshëm të armëve në vitin 2002.

Kundër **Skender Halilajt** prokurori publik paraqiti aktakuzë të drejtpërdrejtë më 11 shtator 2002 (nr. 669/2002) për vrasje në tentativë të Hamëz Hajrës të kryer në prill/maj 1998.

Kundër **Skënder Halilajt**, **Burim Ramadanit**, **Arben Kiqinës**, **Arsim Ramadanit**, **Zeqir Kiqinës**, **Florim Kiqinës** dhe **Blerim Kiqinës** prokurori publik paraqiti një aktakuzë më 7 shkurt 2003 (nr. 523/2002) për bashkëpunim dhe ndihmë dhe nxitje të njëri tjetrit në a) vrasje Hamëz Hajrës, Miradije Hajrës, Xhevdet Hajrës, Mimoza Hajrës dhe Adelina Hajrës, b) vrasje në tentativë të Pranvera Hajrës, c) pjesëmarrje në grup që kryen vrasje dhe d) marrëveshje për të kryer veprë penale të ndodhur më 20 gusht 2001.

Kundër **Agim Xhilanit**, **Bekim Morinës**, **Adem Kiqinës** dhe **Muharrem Xhemajlit** prokurori publik paraqiti një aktakuzë më 5 shkurt 2003 (nr. 415/2002) duke i akuzuar të tre të parët për bashkëpunim në a) ndihmë dhe nxitje të kryerësve të vrasjeve të familjes Hajra, b) ndihmë dhe nxitje të kryerësve të vrasjeve në tentativë të Pranvera Hajrës, c) mos lajmërim të kryerjes së një veprë penale, d) mos lajmërim të veprës penale apo të kryerësit, e) ndihmë të kryerësit pas kryerjes së veprës penale, dhe të katërtin për f) ndihmë të kryerësit pas kryerjes së veprës penale.

4. Më 16 shtator 2003 kolegji vendosi të konsolidojë aktakuzat e ndryshme dhe të bashkojë procedurat kundër Skënder Halilajt dhe Kimete Krasniqit për vrasje në tentativë të kryer më 1998 me procedurat lidhur me vrasjet dhe vrasjet në tentativë tjera të kryera më 2001.

Vendi i gjykimit u ndryshua prej Prishtinës në Gjilan me vendim të PSSP-së më 7 tetor 2003.

Shqyrtimi gjyqësor filloi më 4 nëntor 2003 dhe zgjati deri më 7 prill 2005

Pas 107 shqyrtimeve aktgjykimi u shpall më 7 prill 2005.

Të pandehurit ishin shpallë fajtorë për këto vepra penale:

- **Skender Halilaj** (aktakuza PP. Nr. 669/2002 e datës 11 shtator 2002),

i. Vrasje në tentativë të Hamëz Hajrës në mes datës 17 prill dhe 30 maj 2008, duke vepruar në bashkëpunim me Kimete Krasniqin dhe të tjerët.

- **Skënder Halilaj**, Burim Ramadani, Arben Kiqina, Arsim Ramadani, Zeqir Kiqina, Florim Kiqina dhe Blerim Kiqina (aktakuza PP. Nr. 523/2002 e datës 7 shkurt 2003),

ii Vrasje të Hamëz Hajrës, Miradije Hajrës, Xhevdet Hajrës, Mimoza Hajrës dhe Adelina Hajrës më 20 gusht 2001 në rrugën mes fshatrave Baicë dhe Tërstenik, të gjithë në bashkëpunim dhe ndihmë dhe nxitje të njëri tjetrit,

iii. Vrasje në tentativë ndaj Pranvera Hajrës më 20 gusht 2001 në rrugën midis fshatrave Baicë dhe Tërstenik, të gjitha në bashkëpunim dhe duke ndihmuar dhe nxitur njëri tjetrin,

iv. Pjesëmarrje në grup që kryen vrasje (të anëtarëve të familjes së Hamëz Hajrës), të gjitha në bashkëpunim dhe duke ndihmuar dhe nxitur njëri tjetrin

v. Marrëveshje për kryerjen e vrasjes (të anëtarëve të familjes së Hamëz Hajrës), të gjitha në bashkëpunim dhe duke ndihmuar dhe nxitur njëri tjetrin,

- Agim Xhilani, Bekim Morina, Adem Kiqina (aktakuza PP. Nr. 415/2002 e datës 5 shkurt 2003),

vi. Mos lajmërimi i përgatitjes së veprës penale të vrasjes së Hamëz Hajrës dhe familjes së tij.

- Muharrem Xhemajli (aktakuza PP. Nr. 415/2002 e datës 5 shkurt 2003),

vii. Ndihmë kryerësit pas kryerjes së veprës penale.

- **Kimete Krasniqi** (aktakuza PP. Nr. 305/2002 e datës 3 korrik 2002),

viii. Vrasje në tentativë ndaj Hamëz Hajrës mes datës 17 prill dhe 30 maj 2008, e motivuar nga përfitimi personal, hakmarrja e pamëshirshme, motive tjera bazike apo hakmarrja, duke vepruar në bashkëpunim me Skënder Halilajn,

ix. Posedim i paligjshëm i armëve mes janarit 2001 dhe 6 prillit 2002.

Të pandehurit ishin dënuar si në vijim:

Skender Halilaj dënim total me burgim afatgjatë prej 30 vitesh,

Burim Ramadani, Arben Kiqina dhe Arsim Ramadani dënim total me burgim afatgjatë prej 30 vitesh

Zeqir Kiqina dënim total me burgim afatgjatë prej 11 vitesh,

Florim Kiqina dënim total me burgim afatgjatë prej 21 vitesh,

Blerim Kiqina dënim total me burgim afatgjatë prej 11 vitesh,

Agim Xhylani, Bekim Morina dhe Adem Kiqina me 4 vite burgim secili,

Muharrem Xhemajli to 4 vite burgim,

Kimete Krasniqi dënim total me burgim prej 6 vitesh.

Të pandehurit Agim Xhylani, Bekim Morina dhe Adem Kiqina ishin liruar nga akuzat e bashkëpunimit në a) ndihmë dhe nxitje të kryerësve të vrasjes së familjes Hajra, b) ndihmë dhe nxitje të kryerësve të vrasjeve në tentativë të Pranvera Hajrës, d) mos lajmërim të kryerjes së veprës penale të vrasjes së Hamëz Hajrës dhe së familjes së tij, apo të kryerësve, e) ndihmë të kryerësit të vrasjes së Hamëz Hajrës dhe familjes së tij pas kryerjes së veprës penale.

5. Të gjithë të pandehurit kanë paraqitur ankesa kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan.

Pas shqyrtimit të mbajtur më 20 maj dhe këshillimit të mbajtur më 21 maj dhe 26 qershor 2008, Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin e saj AP – KZ 393/2006, ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës së Shkallës së Parë si në vijim:

i. Ankesat e paraqitura në emër të Burim Ramadani, Arben Kiqinës, Arsim Ramadani dhe Blerim Kiqinës u pranuan pjesërisht,

këta katër të pandehur ishin shpallë fajtorë për veprat penale të pesë vrasjeve të rënda me qëllim dhe një vrasje e rëndë në tentative me qëllim, në kundërshtim me nenin 30 paragrafët 1 dhe 2 (pika 1) dhe 3 të LPK-së lidhur me nenet 19 dhe 22 të LP të RSFJ-së, të zbatueshme përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 (vepra të dënueshme edhe me nenet 146, 147 pikat 3 dhe 11 lidhur me nenet 20 dhe 23 të KPPK-së), sepse ata së bashku i morën jetën Hamëz Hajrës, Miradije Hajrës, Xhevdet Hajrës, Mimoza Hajrës dhe Adelina Hajrës dhe tentuan ti marrin jetën edhe Pranvera Hajrës në mënyrë tinëzore; më 20 gusht 2001 në orën 23:00 në rrugën midis fshatrave Baicë dhe Tërstenik.

Burim Ramadani, Arben Kiqina dhe Arsim Ramadani u dënuan me 30 vite burgim, ndërsa Blerim Kiqina ishte dënuar me 11¹ vite burgim.

Burim Ramadani, Arben Kiqina, Arsim Ramadani dhe Blerim Kiqina ishin liruar nga të gjitha akuzat tjera kundër tyre.

ii. Ankesat e paraqitura në emër të **Skender Halilajt** dhe **Kimete Krasniqit** u pranuan pjesërisht dhe dy të pandehurit u shpallën fajtorë për veprën penale vrasje në tentative

¹ Dënimi kundër Blerim Kiqinës ishte caktuar të jetë 10 vite burgim por, me një aktvendim të Gjykatës Supreme të datës 18 nëntor 2008 dhe të bërë në përputhje me nenin 358 të LPP-së, kohëzgjatja prej 10 vitesh u konsiderua si gabim material dhe u korigjua në 11 vite sipas aktgjykimit të shkallës së parë që u konfirmua mbi këtë pikë.

me qëllim, në kundërshtim me nenin 30 paragrafi 1 i LPK-së lidhur me nenet 19 dhe 22 të LP të RSFJ-së, të zbatueshme përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 (vepra të dënueshme edhe me nenet 146 lidhur me nenet 20 dhe 23 të KPPK-së), sepse ata së bashku edhe me bashkëpjesëmarrës të paidentifikuar tentuan ti marrin jetën Hamëz Hajrës më 14 apo 15 maj 1998 afër udhëkryqit në mes rrugës për Skenderaj dhe rrugës për Tërstenik 2 .

Kimete Krasniqi për më tepër u shpall **fajtores** për vepër penale posedim ilegal të armëve në kundërshtim me nenin 199 paragrafi 1 i LPK-së dhe nenin 8.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/17 (vepër e dënueshme edhe me nenin 328 paragrafin 2 të KPPK-së), prej janarit 2001 deri më 6 prill 2002 në Prizren.

Skender Halilaj u dënua me 5 vite burgim, **Kimete Krasniqi** me dënim total prej 5 vitesh dhe 6 muajsh burgim.

Skender Halilaj u lirua nga të gjitha akuzat tjera kundër tij.

iii. Ankesat e paraqitura në emër të Zeqir Kiqinës, Florim Kiqinës, Agim Xhilanit, Bekim Morinës, Adem Kiqinës dhe Muharrem Xhemajlit u pranuan dhe ata janë liruar nga të gjitha akuzat kundër tyre.

6. Skender Halilaj është arrestuar më 6 korrik 2002 dhe është liruar më 26 qershor 2002, Kimete Krasniqi është arrestuar më 5 prill 2002 dhe është liruar më 3 nëntor 2002.

7. Avokatët mbrojtës të personave të dënuar kanë paraqitur mjet të jashtëzakonshëm juridik kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme AP – KZ 393/2006, si në vijim.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Vahide Brahës si avokate mbrojtëse e të pandehurit Skender Halilajt është paraqitur më 24 tetor 2008.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Z. Destan Rukiqit si avokat mbrojtës i të pandehurës Kimete Krasniqit është paraqitur më 18 shtator 2008.

8. ZPPK-së ka paraqitur mendimit e tij më 3 dhjetor 2008.

9. Pas dorëzimit të lëndës te Gjyqtarët e EULEX-it në janar 2009, Gjykata Supreme e Kosovës ka mbajtur seancës e saj mbi mjetet e lartpërmendura juridike më 12 tetor 2009.

Gjetjet e Gjykatës

I

10. Faktet e hetuara kanë ndodhur në pranverën e 1998, kur kodi i procedurës në fuqi në Kosovë ka qenë Ligji mbi Procedurën Penale të RSFJ-së (LPP).

Aktakuzat janë paraqitur në mes të korrikut 2002 dhe shkurtit 2003, kurse shqyrtimi gjyqësor ka filluar me 4 nëntor 2003.

Më 6 tetor 2004, ka hyrë në fuqi Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK), neni 550 i të cilit përcakton që Procedura penale në shkallë të parë në të cilën aktakuza, propozimakuza ose padia private është paraqitur para datës së hyrjes në fuqi të këtij Kod, por që nuk janë përfunduar deri në këtë datë, vazhdojnë në pajtim me dispozitat e ligjit të mëparshëm në fuqi deri:

- 1) Në pushim të procedurës penale me aktvendim të formës së prerë ose
- 2) Kur aktgjykimi i marrë në shqyrtim gjyqësor merr formë të prerë.

Dispozitat e nenit 550 të KPPPK-së e bëjnë të qartë që në procedurën aktuale, aktakuzat e të cilës janë paraqitur para hyrjes në fuqi të KPPPK-së, ligj i aplikueshëm ka qenë vetëm LPP, deri sa aktgjykimi është bërë i formës së prerë.

Rrjedhimisht, në shkallën e parë dhe të dytë (dhe për të pandehurit tjerë shkalla e tretë gjithashtu) të kësaj procedure është zbatuar LPP-ja.

Duke e pas parasysh pozitën e Skender Halilajt dhe Kimete Krasniqit, aktgjykimi është bërë i formës së prerë më 26 qershor 2008 kur Gjykatat Supreme e Kosovës, si shkallë e dytë, ka vendosur mbi ankesat e tyre kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan. Sa i përket mjeteve të jashtëzakonshme juridike, neni 551.1 i KPPPK-së përcakton që ato të paraqitura para hyrjes së tij në fuqi do të vazhdojnë dhe përfundohen sipas dispozitave të ligjit të mëparshëm të aplikueshëm, që edhe një herë është LPP-ja.

Sa i përket aktgjykimit i cili është bërë i formës së prerë pas hyrjes në fuqi të KPPPK-së, në këtë rast, neni 551, paragrafi 2 i KPPPK-së lejon mundësin e paraqitjes së kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Kjo do të thotë që në këtë rast ligj i aplikueshëm në fazën e mjeteve të jashtëzakonshme juridike është vetëm KPPPK-ja.

11. Aktgjykimi i tanishëm ka të bëjë vetëm me vrasjen e rëndë në tentativë të Hamëz Hajrës e cila ka ndodhur në pranverë të vitit 1998, dhe jo me vrasjen e rëndë të të njëjtës viktimë dhe katër të afërmeve të tij e cila ka ndodhur më 20 gusht 2001, sepse Skender Halilaj ka qenë përfundimisht i liruar nga ato akuza dhe Kimete Krasniqi asnjëherë nuk është ngarkuar me ato.

II

12. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur në emër të Skender Halilajt kundërshton aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së dytë:

- Në bazë të shkeljes së ligjit penal (neni 451, pika 1) dhe
- Në bazë të shkeljes substanciale të dispozitave të procedurës penale të përcaktuar me nenin 403, paragrafi 1(neni 451, pika 2).

13. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon shkelje substanciale të ligjit të procedurës në të dy aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë.

Sa i përket aktgjykimin të parë kërkesa pohon si në vijim.

- Aktgjykimi është bazuar në dëshmi të papranueshme (dëshmi irracionale).

Kjo pikë nuk mund të pranohet.

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk sqaron se cila dëshmi është e papranueshme e as nuk jep arsyet e irracionalitetit të tyre

Kërkesa gjithashtu duket të jetë e përgjithësuar sepse dëshmi të “papranueshme” apo “irracionale” nuk është kualifikimi i cili përdoret në LPP dhe KPPPK për të veçuar shkeljen esenciale të procedurës penale.

Në të vërtetë neni 364, paragrafi 1, pika 8 e LPP-së parasheh rastin kur “aktgjykimi bazohet në dëshmi që mund të mos përdoren si bazë e aktgjykimin nën dispozitat e këtij ligji”.

Neni 403, paragrafi 1, pika 8 e KPPPK-së i referohet “dëshmime të papranueshme”.

Kërkesa nuk sqaron se cila dëshmi dhe pse është e papranueshme.

- I pandehuri nuk është informuar lidhur me aktakuzën dhe nuk ka pasur kohën dhe mjetet adekuate për ta përgatitur mbrojtjen e tij.

Aktakuza drejtpërdrejt kundër Skender Halilajt për akuzën e vrasjes së rëndë në tentativë kundër Hamëz Hajrës ka ndodhur në mes të 17 prillit dhe 30 majit 1998 është paraqitur nga Prokurori më 11 shtator 2002.

Aktakuza e drejtpërdrejt është paraqitur dhe pas kësaj Gjykata e Qarkut sipas nenit 160 të LPP-së, është pajtuar me kërkesën e Prokurorit që të mos zhvillohen hetimet sepse hetimet të plota dhe të hollësishme tanimë janë zhvilluar nga Gjyqtari hetues kundër bashkëkryerëses Kimete Krasniqit.

Sidoqoftë sipas paragrafit 2 të nenit 160 të LPP-së, aktakuza e drejtpërdrejt është paraqitur vetëm pas ekzaminimit të Skender Halilajt lidhur me pjesëmarrjen e tij në këtë krim nga Gjyqtari hetues më 15 dhe më 22 gusht 2002.

Prandaj ai është informuar me kohë lidhur me akuzën gjatë faza së hetimeve.

Aktakuza e drejtpërdrejt i është dorëzuar Skender Halilajt më 13 shtator 2002, dhe përsëri i është dërguar edhe një herë më 20 shtator 2003 (shih dosjen “Aktakuza e Drejtpërdrejt”).

Avokati i tij mbrojtës Bajram Krasniqi është njoftuar për aktakuzën e drejtpërdrejt më 10 prill 2003 (shih ib.).

Vendimi i kolegjit i datës 16 shtator 2003 për ti bashkuar procedurat gjyqësore të ndryshme ka përfshirë edhe atë të aktakuzës kundër Skender Halilajt për vrasjen në tentativë të Hamëz Hjarës më 1998, i është dorëzuar të pandehurit më 23 shtator 2003.

Në shqyrtimin e parë të 4 nëntorit 2003, të gjitha aktakuzat i janë dorëzuar edhe një herë secilit të pandehur dhe avokat mbrojtës.

Me atë rast Skender Halilaj dhe avokati i tij mbrojtës nuk kanë ngritur ndonjë ankesë lidhur me mungesën e njoftimit të tyre për aktakuzën e drejtpërdrejt para fillimit të shqyrtimit gjyqësor.

Shqyrtimi gjyqësor është shtyrë dhe ka zgjatur nga 4 nëntori 2003 deri më 7 prill 2005 përfshirë 107 shqyrtime.

Janë ekzaminuar të gjitha aspektet e akuzave të ndryshme.

Mund të përfundohet që Skender Halilaj, si të pandehurit tjerë, ka qenë i njoftuar me kohë lidhur me akuzat kundër tij dhe ka pasur kohë dhe mjete për ta përgatitur mbrojtjen e tij.

- I pandehuri u deklarua i pafajshëm mirëpo është marrë në pyetje para prezantimit të përgjithshëm të dëshmive kundër tij.

Kjo pikë e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar.

Në të vërtetë, shkëlja substanciale e procedurës penale e ngritur nga pretenduesi është prezantuar ex novo nga KPPPK-ja (neni 403, paragrafi 1, nr. 9) dhe ka të bëjë me një formë kundërshtuese të shqyrtimit gjyqësor ku i pandehuri në fillim pyetet se si deklarohet lidhur me akuzat (neni 358) dhe, nëse ai nuk deklarohet fajtor për secilën pikë, pason prezantimi i dëshmive (neni 360).

Vetëm pas prezantimit të dëshmive, i pandehuri ekzaminohet (neni 371).

Siç u pa më lart, (shih pikën II.13), ligj i aplikueshëm në shkallën e parë dhe të dytë ka qenë LPP-ja dhe jo KPPPK-ja.

Sipas LPP-së, e cila përcakton një formë ndryshe të shqyrtimit gjyqësor, ekzaminimi i të pandehurit (neni 317) vjen para procedurës dëshmuese (neni 322).

Prandaj, Skender Halilaj në mënyrë të duhur, si edhe të pandehurit e tjerë, është ekzaminuar (në shqyrtimet e 20, 26, 27 nëntorit 2, 3 dhe 4 dhjetorit 2004) para prezantimit të dëshmive.

- Kërkesa pretendon që i pandehuri Skender Halilaj është intervistuar nga Policia më 8 korrik 2002, pasi që është arrestuar më 6 korrik për shkak të akuzës së vrasjes së rëndë të Hamëz Hajrës dhe familjes së tij e cila ka ndodhur në mbrëmjen e 20 gushtit 2001.

Gjatë intervistës Policia e ka pyetur Halilajn lidhur me vrasjen në tentativë të Hamëz Hajrës në pranverën e vitit 1998.

Për më tepër, para se të intervistohet, Halilaj nuk është informuar që ai ka qenë i dyshuar për vrasjen në tentativë (shkelje e Rregullores së UNMIK-ut 2001/21, neni 2.1 dhe neni 218.2 të LPP-së) dhe nuk ka qenë i përfaqësuar nga avokati mbrojtës (shkelje e Rregullores së UNMIK-ut 2001/28, nenet 2.1, 2.2 dhe 3, Rregullore së UNMIK-ut 2002/7, neni 3.1 (c) dhe neni 67, paragrafit 1 të LPP-së).

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë pretendon që me atë rast Halilaj është intervistuar para prezantimit të përgjithshëm të dëshmive kundër tij.

Gjykata e shkallës së parë është marrë me pranueshmërinë e deklaratave të dhëna nga të pandehurit para Policisë (faqe 114 - 117) duke ardhur në përfundim që “kolegji nuk i ka përdorur këto deklarata të policisë në mënyrë vendimtare që të bazoj gjetjet kundër cilitdo të akuzuar”.

Gjykata e shkallës së dytë (faqet 44 - 45) ka ekzaminuar dhe refuzuar pretendimet lidhur me shkeljet e pohuara të Rregullores së UNMIK-ut 2002/7 dhe nenit 67.1 të LPP-së, sa i përket deklaratave të procedurës paraprake të bëra nga Skender Halilaj, sepse “përdorimi i deklaratave të kontestuara është absolutisht i panevojshëm” pasi që ajo Gjykatë ka shfrytëzuar vetëm deklaratat e të pandehurit të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Kjo pikë e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Në fakt neni 364, pika 8 e LPP-së parasheh shkeljen esenciale të procedurës penale nëse aktgjykimi bazohet në dëshmi të papranueshme “përveç nëse në dritën e dëshmimeve tjera është e qartë që aktgjykimi i njëjtë do të ishte sjellë edhe pa atë dëshmi”.

Kjo do të thotë që dëshmia e papranueshme mirëpo jovendimtare nuk ka ndikim në aktgjykim duke shkelur në mënyrë procedurën penale.

Nga aktgjykimi i shkallës së parë është e kuptueshme që deklaratat e policisë nuk janë përdorur në mënyrë vendimtare sepse dëshmitë vendimtare dhe relevante kanë qenë të tjera.

Ky arsyetim gjithashtu është konfirmuar nga aktgjykimi i shkallës së dytë dhe duket të jetë korrekt.

Prandaj, në këtë lëndë nuk mund të gjendet asnjë shkelje esenciale e procedurës penale.

- Vepra është përfshirë në grupin e veprave të kryera në kundërshtim të zakoneve të luftës dhe UNMIK-u nuk ka mandat që ti gjykoj rastet e tilla, të cilat bien nën kompetencat e “Gjykatës së Hagës”.

Kualifikimi ligjor i faktit do të ekzaminohet në paragrafët në vijim që kanë të bëjnë me pretendimin e shkeljes së ligjit penal.

Këtu mund të vërehet qe vepra penale e ngarkuar nuk është kualifikuar si krim i luftës nga Prokurori në aktakuzë, e as nga Gjykata e shkallës së parë dhe dytë, mirëpo si krim i rëndomtë.

Për më tepër, është mirë e njohur që qoftë UNMIK-u, para (shih Rezolutën e KB-së 1244/1999, neni 10 dhe Rregullorja e UNMIK-ut 1999/1, neni 1) dhe më vonë Gjyqësori i Kosovës i integruar nga Gjyqtarët e EULEX-it kanë mandat të gjykojnë çdo lloj të veprave penale sipas dispozitave të procedurës së aplikueshme (LPP-së dhe KPPK-së).

Kompetencat e Gjykata Ndërkombëtare për Krime të Luftës në ish-Jugosllavi (GjNKLJ), e njohur si “Gjykata e Hagës” përmendur në kërkesën e të pandehurit, është e natyrës “përkuese” dhe jo ekskluzive (shih nenin 9 e Statutit të GjNKLJ).

Kjo do të thotë që ekzistimi dhe funksionimi i GjNKLJ nuk i privon gjykatat vendore nga kompetencat e tyre për çfarëdo vepre penale.

Për më tepër, pa kërkesë formale dhe specifike të GjNKLJ (e cila mungon në këtë rast) gjykata vendore nuk obligohet që t’ia referoj lëndën në kompetenca të asaj gjykate ndërkombëtare.

- Gjykata ka shkelur nenin 387 të KPPPK-së kur janë bashkuar procedurat gjyqësore të katër të pandehurve.

Së dyti, gjykata ka vendosur ti bashkoj procedurat e ndryshme me kërkesë të Prokurorit e cila më parë nuk i është dërguar të pandehurve dhe avokatëve të tyre mbrojtës duke shkelur procedurat kundërthënëse.

Pretendimi lidhur me bashkimin e procedurave që kanë të bëjnë me vrasjen në tentativë të Hamëz Hajrës në pranverën e vitit 1998 dhe vrasjen e rëndë të këtij të fundit dhe katër anëtarëve të familjes së tij në gusht 2001, tanimë është ngritur në shkallën e dytë dhe është refuzuar nga ajo Gjykatë (faqe 11).

Gjykata e shkallës së dytë ka arsyetuar se, madje edhe në rast se vendimi për bashkimin e procedurave gjyqësore mund të ishte i gabuar, kjo gjë nga ligji nuk është konsideruar si shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale (neni 364.1 i LPP-së).

Kjo gjykatë konsideron pretendimin e ankuesve si të pabazë duke pasur parasysh: së pari, që neni 32 i LPP-së përcakton mundësinë e bashkimit të procedurave për disa persona dhe disa vepra penale, nëse veprat penale janë të lidhura njëra me tjetrën dhe dëshmitë janë të njëjta (paragrafi 6), ose nëse procedurat e veçanta janë zhvilluar para të njëjtës gjykatë kundër të njëjtit person për më shumë sesa një vepër penale (paragrafi 7).

Në këtë rast, vendimi për bashkimin e procedurave ka qenë i drejtë në përputhje me paragrafin 7, sepse i njëjti person (Skender Halilaj) është akuzuar edhe me faktet e vitit 1998 edhe me ato të vitit 2001. Kjo gjë ka sjellë deri tek raporti reciprok midis dy fakteve.

Së dyti, vendimi për bashkimin e procedurave gjyqësore është marrë nga gjykata e shkallës së parë më 16 shtator 2003, pas propozimit të prokurorit të paraqitur më 4 shtator 2003, dhe para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, seanca e parë dëgjimore e të cilit është mbajtur më 4 nëntor 2003.

Sipas LPP-së, fuqia për bashkimin e procedurave të ndryshme gjyqësore (neni 32) është e ekuilibruar me fuqinë për ndarjen “nga arsye të rëndësishme të përshpejtimit” të procedurave gjyqësore për vepra të caktuara penale (neni 33). Kjo do të thotë se dhe në rastet kur gjykata ka bashkuar procedurat e ndryshme gjyqësore pa marrë paraprakisht mendimin e avokatëve mbrojtës, gjykata e shqyrtimit gjyqësor ka gjithmonë fuqinë që përsëri t’i ndajë këto procedura me kërkesë të mbrojtjes.

Kjo gjë mundëson përjashtimin e çdo shkeljeje të së drejtës në procedurën e kundërt siç parashihet me ligjin vendor dhe me instrumentet ndërkombëtare, sepse palët kanë pasur mundësinë që t’i paraqesin arsyet e tyre dhe të kërkojnë ndarjen e procedurave që nga fillimi i shqyrtimit gjyqësor.

- Dispozitivi ka qenë i pakuptueshëm dhe kontradiktor sepse gjykata nuk ka marrë parasysh rrethanat e jashtëzakonshme të luftës dhe uniformat e të palëve ndërluftuese dhe hierarkinë komanduese.

Cilësimi juridik i faktit do të shqyrtohet në paragrafët e ardhshëm që kanë të bëjnë me shkeljen e pohuar të ligjit penal. Këtu mund të vërehet se edhe dispozitivi i aktgjykimit të parë edhe i atij të dytë nuk mund të përshkruhen si të pakuptueshëm dhe kontradiktorë.

Aktgjykimi i parë (12 dhe 13) e bën të qartë veprën e ngarkuar penale (vrasje në tentativë e kryer në pritë nga Skender Halilaj, Kimete Krasniqi dhe personat e tjerë kundër Hamëz Hajrës), faktet dhe rrethanat që tregojnë natyrën penale të veprës së kryer si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varen dispozitat përkatëse të ligjit penal (mënyra, koha dhe vendi i veprës).

Aktgjykimi i dytë (faqe 7) sqaron elementet e njëjta që përjashtojnë disa nga rrethanat rënduese. Kjo përjashton çdo formë të paqartësisë ose të kundërshtive në dispozitiv.

Sa i përket aktgjykimit të shkallës së dytë, kërkesa pohon si më poshtë:

- Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë pohon se gjykata e shkallës së dytë nuk ka marrë parasysh shkeljet procedurale të bëra nga gjykata e shkallës së parë të treguara në ankesën e të pandehurit dhe të referuara në nenin 364, par. 1.11 dhe par. 2 të LPP-së.

Së dyti, kërkesa pohon se Skender Halilaj kurrë nuk ka pasur mundësinë e shfrytëzimit të së drejtës së kundërshtimit të deklaratave të dhëna nga Kimete Krasniqi.

Pika e parë duket të jetë e pabazë, sepse lidhur me pjesën që flet për vrasjen në tentativë të Hamëz Hajrës në vitin 1998, të dy aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë përmbajnë një analizë të plotë të dëshmive dhe fakteve, një arsyetim të qëndrueshëm logjik rreth gjendjes faktike dhe përfshirjes së të pandehurve dhe një zbatim të drejtë të parimeve gjyqësore në faktet e konstatuara. Në aktgjykimin e shkallës së parë dhe të asaj së dytë nuk mund të gjendet asnjë kundërshti në mes të procesverbalit dhe aktgjykimit.

Së dyti, është e vërtetë se Skender Halilaj kurrë nuk ka pasur mundësinë e kundërshtimit të deklaratave të Kimete Krasniqit, sepse ajo është gjykuar në mungesë dhe vetëm deklaratat e saj të dhëna para gjyqtarit hetues (më 6 prill, më 8 maj dhe më 2 korrik 2002) janë lexuar në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor.

Përkundër kësaj, deklaratat e saj janë lexuar në procesverbal pa asnjë kundërshtim nga ana e të akuzuarit (shqyrtimi i datës 28 prill 2004, faqe 38). Për më tepër, në deklaratën e saj të dhënë para gjyqtarit hetues, Kimete Krasniqi gjithmonë ka refuzuar akuzat dhe kurrë nuk ka akuzuar Skender Halilajn. Në këtë mënyrë, nuk ka pasur kundërshtim nga të pandehurit, duke përfshirë Halilajn, lidhur me përdorimin e deklaratave të Kimete Krasniqit, të cilat deklarata nuk kanë qenë në dëm të Halilajt.

Kështu mosdhënia e mundësisë Halilajt për t'i kundërshtuar deklaratat e Krasniqit duket të jetë pranuar nga vetë Halilaj dhe në fund të fundit një gjë e tillë nuk ka rëndësi në mbrojtjen e tij. Dëshmi tjetër është një dokument i shkruar nga Kimete Krasniqi përkitazi me vrasjen në tentativë, në të cilin përmendet emri i Halilajt si njëri nga kryerësit.

Megjithatë, kjo nuk është deklaratë verbale por deklaratë me shkrim dhe përdorimi i saj nuk shkel të drejtën e mbrojtjes së Halilajt.

- Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë lidhur me aktgjykimin e shkallës së dytë, ri-përsërit po ashtu pohimin mbi shkelje të nenit 32, par. 6 të LPP-së rreth vendimit për bashkimin e procedurave gjyqësore, që dalin nga të katër aktakuzat.

Kjo pikë tashmë është shqyrtuar dhe është refuzuar më lart.

14. Shkeljet e pohuara të ligjit penal

- Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë pohon se edhe aktgjykimi i parë edhe i dytë kanë shkelur ligjin penal në dëm të të akuzuarit duke zbatuar nenin 30 të LPK-së, lidhur me nenet 19 dhe 22 të Ligjit penal të Republikës Socialiste të Jugosllavisë në vend të zbatimit të zakoneve të luftës.

Pretendimi është i motivuar në tri pika:

- Kompetenca e gjykatave të UNMIK-ut (për këtë shih paragrafin paraprak **II.13**),
- Viktima ishte një luftëtar “nga radhët e armikut, derisa i pandehuri ishte një ushtar i thjeshtë” dhe “sipas nenit 3 të Konventës së Gjenevës, nuk përcaktohet mënyra në të cilën bëhet prita ndaj armikut, në këtë rast ndaj spiunit të Serbisë si palë ndërluftuese”;
- Aktgjykimi i kundërshtuar nuk ka zbatuar nenin 10 të KPPK-së, i cili ofron justifikim për kryerësin material kur vepra penale kryhet përmes një urdhri të dhënë nga qeveria ose nga eprori më i lartë.

Kjo pikë nuk është e bazuar. Në fakt, nuk mund të gjendet asnjë shkelje e ligjit penal, e cila shkon në dëm të të akuzuarit. Gjykata e shkallë së dytë ka vënë re (në faqen 44) se Hamëz Hajra “nuk ka qenë ushtar: ai nuk ka qenë luftëtar dhe nuk ka pasur të veshur uniformë. Siç dëshmohet nga vëllai dhe nga e bija e viktimës (Hajrush Hajra dhe Pranvera Hajra), Hamëz Hajra ka qenë vetëm një polic i angazhuar të merret me rastet e vjedhjeve”. Kjo vërejtje duket të jetë me vend. Mund të shtohet se jurisprudenca vendore dhe instrumentet ndërkombëtare janë të qarta lidhur me përjashtimin e pjesëtarëve të policisë civile nga grupi i personave të cilët marrin pjesë në konflikt të armatosur.

Në aktgjykimin e saj të datës 12 maj 2005 në lëndën Rrustem Dema dhe të tjerët (në faqet 51 dhe 52), Gjykata e Qarkut të Prishtinës ka deklaruar në mënyrë bindëse:

“gjatë luftërave bashkëkohore, policia mbetet “civile” dhe duhet që të konsiderohen si të tillë,² nëse nuk kanë marrë pjesë drejtpërdrejt në armiqësi ose nëse nuk janë caktuar në mënyrë specifike si pjesë e forcave të armatosura dhe nëse plotësojnë kushtet për forca

² Shih Rezolutën e Këshillit të Evropës 690 (1979) mbi Deklarimin për Policinë – Neni 1.1. C. -1. Polici vazhdon t'i kryejë detyrat e veta për mbrojtjen e personave dhe të pronës gjatë luftës dhe gjatë pushtimit nga armiku të popullsisë civile. Për këtë arsye, ai nuk ka statusin e “luftëtarit”, prandaj nuk zbatohen dispozitat e Konventës së tretë të Gjenevës të datës 12 gusht 1949, lidhur me trajtimin e të burgosurve të luftës. -2. Dispozitat e Konventës së Gjenevës më 12 gusht 1949, lidhur me mbrojtjen e personave civilë gjatë kohës së luftës, zbatohen edhe për policinë civile. – Shih gjithashtu KNKK-në, komentet e nenit 59 të Konventës së katërt të Gjenevës, paragrafin 2279 – “në shumë shtete, policia komunale, krahinore dhe shtetërore është krejtësisht popullsi civile”

paramilitare (komandë përgjegjësie, shenja dalluese ushtarake, mbajtje të hapur të armëve, dhe zbatim të zakoneve të luftës).³ Policët pa detyra luftarake, për këtë arsye, nuk janë objektiva legjitimë ushtarakë, por vetëm civilë dhe për këtë arsye, persona të mbrojtur⁴”.

Në këtë rast nuk ka dëshmi që Hamëz Hajra mund të ishte spiun që punonte për serbët, ose të ishte armik, siç pohohet nga i pandehuri.

Çdo veprim kundër sigurisë së tij, siç është tentativa për ta vrarë, nuk do të konsiderohej si veprim luftarak kundër një armiku, por një gjë e tillë ishte krim.

Së dyti, dispozita e nenit 10 të KPPK-së është e përgjithshme, prandaj e njëjta mund të zbatohet pavarësisht krimeve të rëndomta ose të krimeve të luftës

Në këto procedura, neni 10 i KPPK-së, nuk i ofron të pandehurit arsyetim.

Në fakt, urdhri më i lart vetëm pohohet mirëpo nuk demonstron me asnjë dëshmi.

Për më tepër, edhe nëse dëshmohet, urdhri për të vrarë një civil ashikare i paligjshëm dhe prandaj nuk mund të arsyetohet sjelljen e të pandehurve.

Së treti, mund të vërehet që në këtë rast mungojnë dëshmitë e njërit element konstituiv të krimeve të luftës, i cili është lidhje në mes krimin të pohuar dhe konfliktit të armatosur.

Që veprimi ka pas për qëllim vrasjen e armikut nuk është demonstruar fare dhe ka mund të jetë motivuar nga sqarimet alternative si akt i hakmarrjes për arsye personale.

Përfundimisht, edhe në rast se aktakuza dhe dy aktgjykimet e para kanë qenë gabim në pikën e kualifikimit ligjor të këtij akti dhe kjo do të duhet të kualifikohet si krim i luftës, ky gabim nuk do të jetë në dëm të të akuzuarit.

Prandaj, i akuzuari nuk ka dobi që ta ngrit atë, e as nuk mund të theksohet si ex officio sipas nenit 415, paragrafit 1, pikës 4 të KPPK-së, dhe nenit 367, paragrafit 1, pikës 2 të LPP-së.

Marrë parasysh sipas peshës së dënimit, të dy krimet trajtohen njëjtë.

Në fakt, sipas nenit 142 të KP RSFJ-së, krimi i luftës dënohet me burgim prej 5 deri në 15 vjet⁵, kurse krimi i vrasjes sipas nenit 30, paragrafit 1 të LPK-së i zbatuar në këtë rast nga Gjykata e shkallës së dytë është i dënueshëm me prej 5 deri në 15 vjet burgim.

Neni 19 i KP RSFJ-së është i përbashkët për të dy llojet e krimeve dhe përcakton mundësinë e zvogëlimit të dënimit në rast të tentativës.

³ Neni 4A GCIII, Shih gjithashtu edhe Komentet për Nenin 144 të KPJ-së

⁴ Shih tek urdhrat – Krimet e luftës në Kosovë (Organizata Human Rights Watch), Kapitulli 19, Mbrojtja e popullsisë civile - faqe 496 (<http://www.hrw.org/reports/2001/kosovo/>) dhe Raportet e grupit punues B, Komisioni I, 18 mars 1975 (CDDH/I/238/Rev.1; X, 93), në Howard S. Levie, ed., *Ligji për konfliktin e armatosur jo-ndërkombëtar*, (Dordrecht, Holandë: Martinus Nijhoff, 1987),

⁵ Dënimi me vdekje në fillim i paraparë me nenin 142 LP të RFJ-së është zëvendësuar me 15 vjet burgim, shih Gjykata Supreme e Kosovës, 21 korrik 2005 në lëndën e Prokurorit kundër Latif Gashit et alia.

Marrë parasysh nën pikën e efekteve të ndryshme penale, të dy krimet janë objekt i trajtimit të ndryshëm dhe ai i krimeve të luftës është më pak i favorshëm për të pandehurin se ai për krim të rëndomtë.

Sipas nenit 100 KP të RSFJ-së krimet e luftës nuk janë objekt i parashkrimit për shkak të skadimit të afatit.

Rregulla e njëjtë zbatohet me nenin 95 të KPPK-së.

Në të kundërtën krimi i përcaktuar me nenin 30, paragrafin 1 të LPK-së i nënshtrohet parashkrimit prej 15 vitesh sipas nenit 95, paragrafit 1, pikës 2 të KP RSFJ-së dhe nenit 90, paragrafit 1, pikës 2 të KPPK-së.

Në përfundim, ligji i zbatuar në aktgjykimin e kundërshtuar (neni 30, paragrafi 1 i LPK-së) është më i favorshëm për të pandehurin se ligji për krime të luftës.

Përfundimisht, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë pohon shkeljen e ligjit penal sepse i pandehuri është dënuar për vrasjen në tentativë të Hamëz Hajrës dhe ky fakt është dashur të absorbohet nga vrasja e kryer e viktimës së njëjtë.

Kjo pikë është e pabazuar duke pasur parasysh që dy faktet (vrasja në tentativë në pranverën e vitit 1998 dhe vrasja e rëndë më 20 gusht 2001) nuk ka ndodhur në kontekstin e kohës së njëjtë mirëpo tri vite më vonë.

Prandaj, nuk mund të zbatohet asnjë lloj i absorbimit në këtë rast.

Për shkak të arsyeve të lartpërmendura, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur në dobi të Skender Halilajt duhet patjetër të refuzohet.

III

15. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur në emër të Kimete Krasniqit kundërshton aktgjykimin e Gjykatës së Shkallës së Dytë:

- shkeljeve esenciale të ligjit mbi procedurën penale nga neni 403 paragrafi 1 nënparagrafi 10 dhe 12 i KPPK-së;
- për shkak të shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale që ndikuan në vlefshmërinë e vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe
- për shkak të shkeljes së ligjit penal në dëm të të pandehurit.

Kërkesa propozon të anulohen dy aktgjykimet e Shkallës së parë dhe të dytë dhe të kthehet lënda në Gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

16. Kërkesa po ashtu përmban edhe një propozim, të bërë sipas nenit 453.4 të KPPK-së, për të shtyrë ekzekutimin e aktgjykimit së formës së prerë në pritje të vendimit mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Në këtë kuptim duhet të theksohet se dënimi i dhënë me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Aktgjykimi AP - KZ 393/2006 i datës 20 maj 2008 lidhur me Kimete Krasniqin nuk rezulton ende me ekzekutim.

Për këtë arsye propozimi për të shtyrë ekzekutimin e aktgjykimit në pritje të vendimit të kësaj kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të pranohet.

17. Paraprakisht duhet të vërohet se Kimete Krasniqi ishte fillimisht e akuzuar me dy fakte të ndryshme, a para është vrasje e rëndë në tentativë të Hamëz Hajrës dhe e dyta posedim i paligjshëm i armëve, një pistoletë Zastava e gjetur në shtëpinë e saj dhe në pronësi të saj gjatë bastisjes së datës 6 prill 2002.

18. Në aktakuzën e paraqitur kundër Kimete Krasniqit më 3 korrik 2002 koha e vrasjes në tentativë të Hamëz Hajrës është e shënuar në një ditë "mes 17 prillit 1998 dhe 16 majit 1998".

Gjykata e Qarkut në Gjiçan dënoi të pandehurin për krimin vrasje në tentativë të kryer në ditën "mes 17 prillit 1998 dhe 30 majit 1998".

Gjykata Supreme e Kosovës, si Gjykatë e shkallës së dytë precizoi ditën e faktit duke e treguar ndryshe 14 or 15 maj 1998.

Tregimi i kohës së faktit është i rëndësishëm vendimtar sepse Kimete Krasniqi është e lindur më 24 prill 1980 dhe ligji në fuqi, ai i procedurës dhe ai material, ndryshojnë nëse fakti ishte kryer mes 17 dhe 23 prillit, kur ajo ishte e mitur apo prej 24 prillit deri më 30 maj kur ajo ishte e rritur.

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë pretendon shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të lidhura me të drejtën e të pandehurës për tu konsideruar e mitur në momentin e faktit dhe për tu gjykuar si e tillë e jo në mungesë. (nenet 452.1 dhe 454.1 LPP).

Kjo çështje nuk mund të shpërfilllet duke marrë parasysh vetëm saktësimin e kohës së faktit të bërë nga Gjykata e Shkallës së Dytë, kur e precizoi ditën brenda kornizës të përfshirë në aktakuzë.

Faktikisht kjo çështje ka qenë dashur të ngrihet ex officio që nga fillimi, pasi që lidhet me të drejtat themelore të të pandehurës për tu konsideruar si e mitur dhe si e tillë të gjykohej.

Vërehet se që nga fillimi mund të shihej se, duke u bazuar në kohën e treguar në aktakuzë, ekzistonte një dyshim i konsiderueshëm se ajo mund të ishte e mitur në momentin e faktit.

Prandaj ky dyshim duhej të ishte zgjidhur paraprakisht, para hapave tjerë të procedurës sepse lloji i procedurës dhe pasojat e saj varehin nga zgjidhja e dhënë.

Mungesa e zgjidhjes së kësaj çështjeje në fazën fillestare të gjykimit privoi të pandehurën nga çdo garanci në lidhje me statusin e saj prej të miture dhe zhvleftësoi tërë procedurën që ka të bëjë me veprën penale të vrasjes në tentativë të ngarkuar Kimete Krasniqit.

Përfundimi i arritur nga kjo gjykatë është të anulohet pjesa e aktgjykimit të parë dhe të dytë që ka të bëjë me veprën penale të vrasjes në tentativë të Hamëz Hajrës sa i përket vetëm të pandehurës Kimete Krasniqi dhe të kthehet lënda për rigjykim në Gjykatën e Qarkut në Gjiçan, e cila paraprakisht duhet të zgjidhë problemin rreth statusit të së pandehurës, nëse e mitur apo e rritur.

19. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë pohon se aktgjykimi parë dhe ai i dyti kanë shkelur ligjin penal në dëm të të pandehurës.

- Shkelja e nenit 199 paragrafit 1 të LPK-së sa i përket dënimit të Kimete Krasniqi për shkak të posedimit të paligjshëm të armëve.

Kërkesa së pari pretendon se posedimi i paligjshëm i armës nuk përbën veprë penale dhe së dyti se bazuar në praktikën ligjore pas luftës për vepra penale të tilla janë shpallur dënime me gjobë apo, në momentin më të favorshëm, dënime me kusht, së treti se dënimi duket të jetë i tepruar.

Kjo çështje është e bazuar pjesërisht dhe dy aktgjykimet e para rrjedhimisht duhet të të ndryshohen.

Faktikisht neni 199 paragrafi 1 i LPK-së nuk ndalon posedimin e paligjshëm të asnjë arme por vetëm të atyre “prokurimi i të cilave është i ndaluar për qytetarët”.

Kjo është në përputhje me dënimin e paraparë për këtë krim (burgim me deri në tri vjet) dhe dispozitën e paragrafit të dytë, ku posedimi paligjshëm i dy a më shumë armëve dënohet me një dënim më të butë (deri në një vit burgim).

Shpjegimi është qartë se në paragrafin e dytë dënohet posedimi i çdo lloji të armëve, gjersa në paragrafin e parë dënohet vetëm posedimi i armëve më të rrezikshme, posedimi i të cilave gjithmonë është i ndaluar për qytetarët.

Përfundimi është se, sipas nenit 199 të LPK-së, posedimi i një arme të vetme të llojit të zakonshëm (llojit të paraparë me paragrafin e dytë të nenit 199 të LPK-së), konsiderohet si kundërvajtje.

Kjo vlen për akuzën e posedimit të pistoletës të tipit Zastava dhe municionit të tij për periudhën kohore kur neni 199 i LPK-së ishte në fuqi, pre prej janarit 2001 deri më 4 qershor 2001.

Më 4 qershor 2001 Rregullorja e UNMIK-ut 2001/7 hyri në fuqi, neni 8.2 i së cilës ndalon posedimin joligjor të armëve të çdo lloji dhe numri.

Qartazi Kimete Krasniqi kishte në posedim armën dhe municionin e lartpërmendur prej 4 qershorit 2001 deri në arrestimin e saj në prill 2002 pa leje të vlefshme (WAC).

Në këto kufij aktgjykimet e mëhershme duhet të ndryshohen si në dispozitiv.

Së dyti dënimi i imponuar në aktgjykimin e parë dhe të dytë për këtë fakt brenda kufijve të ligjit në fuqi (Rregullorja e UNMIK-ut 2001/7 Neni 8.6).

Së treti kriteret që Gjykata e mëparshme i ka përcjellë në vendosjen e peshës së dënimit për dy krimet për të cilat ishte dënuar e pandehura duken të jenë të drejta.

Është e qartë se Gjykata kompetente për rigjykim të akuzës së vrasjes në tentativë, në rast të dënimit për atë krim, duhet të zbatojë kriteret e përcaktuara me nenet 48 të KP RSFJ-së dhe 71 të KPPK-së sa i përket dënimit të shkrirë për dy krimet e ndryshme (vrasje në tentativë dhe posedim paligjshëm i armëve).

- Shkelja e neneve 404 nënparagrafëve 6 dhe 73 të KPPK-së në dëm të të pandehurës për shkak se koha e kaluar në paraburgim nuk ishte llogaritur drejt nga të dyja aktgjykimet e kundërshtuara.

Kërkesa nxjerr në pah se të dy aktgjykimet llogarisin kohën e kaluar në paraburgim që prej 5 prill 2002 deri më 30 tetor 2002, gjersa e pandehura faktikisht mbeti në paraburgim deri më 3 nëntor 2002.

Në fakt aktvendimi i datës 4 korrik 2002 vazhdoi paraburgimin deri më 3 nëntor 2002.

Aktgjykimi i parë dhe i dytë llogaritet kohën e kaluar në ndalim prej datës 5 prill deri 30 tetor 2002 në dënimin e imponuar kundër Kimete Krasniqit (shih dispozitivin).

Në shkresat e lëndës gjendet një aktvendim i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës i datës 3 shtator 2002, sipas të cilit e akuzuara Kimete Krasniqi duhet të mbetet në paraburgim në pritje të gjykimit, me një rishikim të arsyeve për mbajtje të mbajtur jo më vonë se data 3 nëntor 2002.

Sipas vendimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës të datës 30 tetor 2002 “paraburgimi i të akuzuarës Kimete Krasniqi ndërpritet; prandaj ajo lirohet menjëherë”.

Ky vendim u dërgua në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan më 31 tetor 2002 dhe Kimete Krasniqi në fakt u lirua më 3 nëntor 2002.

Në këtë rast shkelja e ligjit penal në dëm të të pandehurës është e qartë por mund të ndryshohet edhe nga Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj (shih precedentin specifik Gjykata Supreme e Kosovës 14 dhjetor 2004 Ap. Nr. 352/2004) po ashtu në rast të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë sipas nenit 457 paragrafit 1 pikës 1 të KPPPK-së.

Prandaj, koha e kaluar në paraburgim nga e pandehura Kimete Krasniqi prej 5 prill deri më 3 nëntor 2002 duhet të llogaritet në dënimin e imponuar ndaj saj.

20. Për shkak të arsyeve të përmendura më lart kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur në dobi të Kimete Krasniqit:

- duhet të pranohet pjesërisht dhe aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan në lëndën P. Nr. 162/2003 i datës 7 prill 2005 dhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës AP - KZ 393/2006 i datës 20 maj 2008 duhet të anulohet në pjesën në lidhje me akuzën për vrasje në tentativë e qëllim të ndaj Hamëz Hajrës në kundërshtim të nenit 30, paragrafit 1 të LPK-së lidhur me nenet 19 dhe 22 të Ligjit penal të RSFJ-së. Për këtë pjesë lënda kthehet për rigjykim në Gjykatën e Qarkut në Gjilan.
- duhet të pranohet pjesërisht dhe aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan në lëndën P. Nr. 162/2003 i datës 7 prill 2005 dhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës AP - KZ 393/2006 i datës 20 maj 2008 duhet të ndryshohet:
 - o sa i përket periudhës kohore që kanë të bëjnë me posedimin joligjor të armëve, që është ulur deri në kohën prej datës 4 qershor 2001 deri më 6 prill 2002 dhe sa i përket kualifikimit ligjor të këtij fakti që është vetëm shkelje e Rregullores së UNMIK-ut 2001/7 Neni 8.2;
 - o sa i përket llogaritjes së kohës së kaluar në paraburgim prej datës 5 prill 2002 deri më 3 nëntor 2002.
- Pjesët e mbetura të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur në dobi të Kimete Krasniqit REFUZOHEN si të pabazuara.

Gjykata e Qarkut në Gjilan, në rast të dënimit të Kimete Krasniqit për krimin e vrasjes në tentativë, duhet të zbatojë kriteret e përcaktuara me nenet 48 të KP RSFJ-së dhe 71 të KPPK-së sa i përket dënimit të shkrirë për dy krimet e ndryshme (vrasje në tentativë dhe posedim i paligjshëm i armëve).

IV

21. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës AP - KZ 393/2006 i datës 20 maj 2008 vërtetohet në pjesët të ndryshme nga ato që janë anuluar apo ndryshuar siç është përmendur në paragrafët e mëparshëm.

Shpenzimet e këtyre procedurave ankimore duhet ti bartin dy të pandehurit Skënder Halilaj dhe Kimete Krasniqi, kjo e dyta do ti bartë vetëm shpenzimet që kanë të bëjnë me akuzën për posedim të paligjshëm të armëve.

Sipas nenit 50 të KP RSFJ-së, koha e kaluar në paraburgim nga secili pandehur përfshihet në peshën e dënimit.

Sot më 12 tetor 2009.
Pkl - Kzz - 108/08

Përgatitur në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar.

Kryetari i Kolegjit Ndërkombëtar
Emilio Gatti

Procesmbajtësi Ndërkombëtar
Andrea Chmieliński Bigazzi

Gjyqtari Ndërkombëtar
Norbert Koster

Gjyqtari Ndërkombëtar
Guy Van Craen

Gjyqtari Kosovar
Miftar Jasiqi

Gjyqtari Kosovar
Feizullah Hasani

Mjeti Juridik

Kundër këtij Aktgjykimi nuk lejohet të paraqitet një tjetër kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë (neni 451.2 i KPPPK-së).